

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au
Kosovo

UNMIK/REG/2001/22
20 shtator 2001

RREGULLORE NR. 2001/22
MBI MASAT KUNDËR KRIMINALITETIT TË ORGANIZUAR

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik të vitit 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke pasur parasysh eskalimin e dhunës, kërcënimeve dhe korrupsionit, si pasojë e kriminalitetit të organizuar, të cilat paraqesin kërcënim ndaj demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë,

Duke e marrë parasysh nevojën për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit të organizuar në Kosovë,

Me qëllim të përkufizimit të qartë të kriminalitetit të organizuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale, siç është përcaktuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Krimin e Organizuar Transnacional dhe

Me qëllim të vendosjes së masave legjislative për ndjekjen dhe dënimin e kryerësve të kriminalitetit të organizuar,

Me anë të kësaj Rregullore shpall sa vijon:

Neni 1
Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

(a) “Kriminalitet i organizuar” do të thotë kryerja e “një krimi të rëndë” nga një “grup i organizuar” me qëllim të përfitimit financiar ose të ndonjë përfitimi tjetër material të drejtpërdrejtë apo indirekt,

(b) “Krim i rëndë” do të thotë sjellja që përbën një shkelje të dënueshme me dënim maksimal të heqjes së lirisë së paku deri në katër vjet dhe

(c) “Grup i organizuar” do të thotë një grup prej tre apo më shumë personave që:

(i) ekziston për një periudhë kohore dhe vepron në bashkëpunim e me qëllim të kryerjes së një apo më shumë krimeve të rënda;

(ii) nuk është organizuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre dhe

(iii) nuk ka nevojë të ketë role formalisht të definuara për anëtarët e tij, për vazhdimësi të anëtarësisë apo për strukturë të zhvilluar.

Neni 2

Dënimet për veprat e kriminalitetit të organizuar

2.1 Dënimet e parapara në këtë nen për kryerjen e një krimi të organizuar do t’i shtohen dënimit të shqiptuar për kryerjen e “krimit të rëndë” brenda kufijve të përcaktuar në nenin 48 të Kodit penal në fuqi.

2.2 Çdo person i cili kryen një krim të organizuar i nënshtrohet dënimit me burgim prej 5 deri në 15 vjet dhe gjobitet deri në 250.000 DM.

2.3 Çdo person që ndihmon ose orvatet të ndihmojë apo të nxisë kryerjen e një krimi të organizuar i nënshtrohet dënimit minimal prej katër deri në shtatë vjet burgim si dhe një gjobe deri në 250.000 DM.

2.4 Pa marrë parasysh dispozitën e nenit 26 të Ligjit në fuqi mbi përgjegjësinë penale dhe dënimin e organizatorëve të grupeve kriminale, çdo person që organizon, themelon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton aktivitetet e një “grupit të organizuar”, siç është përkufizuar në nenin 1, i nënshtrohet dënimit prej 7 deri në 20 vjet burgim dhe një gjobe deri në 1.000.000 DM, ose dënimit me burgim prej 20 deri në 40 vjet dhe një gjobe deri në 1.000.000 DM kur aktivitetet e atij grupi rezultojnë me vdekje. Megjithatë, nëse personi i tillë e informon policinë apo prokurorin publik për ekzistimin, formimin dhe ofron informacione të detajuara të këtij grupi për t’i mundësuar policisë që ta arrestojë apo prokurorit që ta ndjekë këtë grup, ai apo ajo mund të të lirohet nga dënimi nëse informimi bëhet para kryerjes së krimit.

2.5 Çdo person i cili frikëson, kërcënon, detyron, ofron apo jep diçka me vlerë, ndikon në personin tjetër ose i shtrembëron faktet me qëllim që ta detyrojë personin t’i fshehë informatat, ose jep informata të rrejshme apo nuk jep informata të vërteta para gjyqtarit, para prokurorit publik a policisë kur ajo informatë ka të bëjë me kryerjen e krimit të organizuar, i nënshtrohet dënimit me burgim prej katër deri në shtatë vjet dhe me gjobë deri në 250.000 DM.

Neni 3

Vendosjen e masave të sigurisë

3.1 Gjykata mund të urdhërojë që çdo person i dënuar për krim të organizuar të privohet nga e drejta e ushtrimit të një profesioni, një veprimtarie të pavarur, nga disa apo të gjitha

detyrat që kanë të bëjnë me shpronësimin, eksploatimin, menaxhimin apo përdorimin e pasurisë së dhënë në besim ose ruajtjen e asaj pasurie nëse personi i dënuar për kriminalitet të organizuar ka keqpërdorur pozitën e tij apo të saj, ushtrimin e aktivitetit apo të detyrës me qëllim të kryerjes së një krimi të organizuar dhe nëse me arsye mund të pritët që ushtrimi i një profesioni, aktiviteti apo detyre të tillë mund të keqpërdoret për të kryer një krim të organizuar.

3.2 Gjykata gjithashtu përcakton kohëzgjatjen për masën e ndërmarrë sipas rënparagrafit (a) të këtij neni, e cila nuk mund të jetë më pak se një vit dhe as më shumë se pesë vite, duke filluar nga dita kur aktgjykimi hyn në fuqi, me kusht që koha gjatë vuajtjes së burgimit ose qëndrimit në një institucion mjekësor pas shqiptimit të dënimit për krimin e organizuar të mos llogaritet në kohëzgjatjen e kësaj mase.

3.3 Nëse ndonjë person shkel një urdhëresë të gjykatës sipas paragrafit 3.1 të këtij neni, ai ose ajo kryen vepër penale dhe pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit me burg deri në një vit.

Neni 4 Zbatim

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 4 Ligji në fuqi

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me këtë.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 shtator 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm